

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtares së vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarve: M.C, N.B. dhe D.B. që të tre nga ..., për shkak të veprës penale në bashkëveprim si bashkekzekutor kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 parag.1 nënparagr. 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH nga Gjilani PP.nr.715/2012 të dt. 04.05.2012, në shqyrtimin e hapur gjyqësor, më dt.15.03.2017 komunikoi, ndërsa më dt. 31.03.2017 përpiloi këtë.

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. M.C., në bazë të evidencës që posedon kjo gjykatë i dënuar më parë për veprë penale, udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale,

2. N.B., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë ka qenë i dënuar më parë për veprë penale, udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

Në bazë të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 I KPPRK-së,

Lirohen nga akuza

Më datë 13.12.2011, në kohë të papërcaktuar, në fsh. ..., të pandehurit me qëllim që vetes ti sjellin përfitim të kundërligjshëm pasuror, kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë, në dëm të të dëmtuarit Zh.S., në atë mënyrë që me një palë gërrshërë kanë prerë dryrin dhe kanë thyer bravën dhe dyert e hyrjes së shitores, janë futur brenda dhe nga aty kanë vjedhur cigare të llojeve të ndyshme si: mallboro, klasik, llaki, winston, ronhill, eva, monte carl dhe një telefon “Samsung E-250”, në këtë mënyrë të dëmtuarin e kanë dëmtuar në shumë të papërcaktuar,

- me çka në bashkëveprim si bashkekzekutor kishin për të kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 parag.1 nënparagr. 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së.

I dëmtuari Zh.S. nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate .

A r s y e t i m

Prokuroria Publike komunale në Gjilan, me aktakuzën PP.nr.715/2012 prej datës 04.05.2012, ka akuzuar M.C., **N.B.** dhe D.B. që të tre nga..., për shkak të veprës penale në bashkëveprim si bashkekzekutor kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 parag.1 nënparagr. 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së, pranë të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që gjykata nga provat e shtjelluara dhe pas krahasimit detal të të njëjtave të akuzuarit t'i shpallë fajtor dhe t'i dënojë në përputhje me ligjin.

Gjykata konform nenit 36 të KPPRK-së ka bërë veçimin e procedurës penale për të akuzuarin D.B., procedura për të njëjtin do të zhvillohet dhe do të përfundohet ndaras.

I dëmtuari Zh.S. në fjalën e tij përfundimtare nuk i 'u ka bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk parashtrori kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari M.C. në mbrojtjen e tij ka kontestuar në tërësi faktin se së bashku me N. e D.B. të kenë kryer vjedhje të rëndë në shitoren e të dëmtuarit Zh.S. i njëjti në mbrojtjen e tij deklaron se, as që e di se ku gjendet shitorja e të dëmtuarit ku e ka cek D.B. dhe habitet me faktin pse është akuzuar se me cilën provë.

Në fjalën e tij përfundimtare deklaron se: nuk e ndien fare veten fajtorë për veprën penale për të cilën është akuzuar nga prokuroria e shtetit, kërkon nga gjykata që pas shqyrtimit të mirëfilltë të të gjitha provave që disponon ta liroj nga përgjegjësia penale për veprën për të cilën akuzohet .

I akuzuari N.B. në mbrojtjen e tij ka kontestuar në tërësi faktin se së bashku me M.C e D.B. të kenë kryer vjedhje të rëndë për të cilën akuzohet duke theksuar se nuk ka njohuri ku gjendet kjo shitore e as që e njehë pronarin e kësaj, habitet me faktin se prokuroria në cilën provë e ka bazuar aktakuzën .

Në fjalën e tij përfundimtare deklaron se: nuk e ndien fare veten fajtorë për veprën penale për të cilën është akuzuar nga prokuroria e shtetit, kërkon nga gjykata që pas shqyrtimit të mirëfilltë të të gjitha provave që disponon ta liroj nga përgjegjësia penale për veprën për të cilën akuzohet .

Gjykata në seancën për shqyrtimin kryesor ka administruar provat e propozuara nga PTH-ja në Gjilan, dëgjimin e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit Zh.S., dëshmitarët: B.C. , Z. e B, L.B., D.T., B.K. dhe J.B. , ndërsa prova materiale për të proceduar nuk ka pasur .

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit Zh.S. në dëshminë e tij ka deklaruar se në shitoren ushqimore STR “ ...”, pronar i së cilës është në fund të vitit 2011 është thyer dryri dhe është depërtuar me forcë, me ç’rast janë marr të gjitha parat të cilat kanë qenë monedha në euro dhe në dinar, përafërsisht 100 €, përpos parave janë vjedhur edhe cigare të llojeve të ndryshme ku vlera e tyre është përafërsisht 700 €, nuk ka dyshuar në askënd, sendet e vjedhura nuk ju janë kthyer asnjëherë.

Dëshmitarët: L.B., B.C., Z.B. në dëshmitë e tyre kanë deklaruar, se fare nuk kanë njohuri për rastin e vjedhjes për çka janë ftuar të dëshmojnë dhe ndihen të befashuar pse prokuroria i ka propozuar si dëshmitar pasi që nuk dinë asgjë lidhur me rastin konkret, ndërsa dëshmitarja Z.B. shton se policia e kanë informuar për D.B. (djalin e saj) se i njëjti ka pranuar se ka kryer veprat penale edhe në rastet kur ato vepra i ka kryer dikush tjetër për shkak të deklaratave të tij jo të matura është detyruar ta dërgojnë djalin e saj D. tek doktori psikiatër A.C. për çka edhe në atë periudhë ka përdorë terapi .

Dëshmitarët zyrtarët policor B.K. e J.B. në dëshmitë e tyre deklarojnë në rastin konkret nuk kanë qenë të kyçur direkt në hetime, por vetëm kanë asistuar gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve, nuk kanë njohuri se kush ka qenë kryerës i kësaj vepre penale, të dyshuarit M.C. dhe N.B. nuk kanë pranuar se kanë kryer veprën penale për të cilën janë dyshuar ndërsa D. B. i ka pranuar të gjitha veprat për të cilat janë dyshuar, mirëpo gjatë intervistimit kanë marr informatë dhe ju është dukur se D. nuk është në gjendje të rregullt për çka e kanë dërguar tek prokurori i shtetit për ta intervistuar, D. sipas deklaratës së nënës së tij në atë periudhë shpesh herë ka qenë nën ndikim të alkoolit.

Të gjitha provat e proceduara gjykata i ka vlerësuar me kujdes, çdo provë veç e veç dhe të tëra së bashku duke i vënë në korrelacion reciprok, si edhe në raport me mbrojtjen e të akuzuarve në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-ës. Në bazë të një vlerësimi të këtillë të kujdesshëm të të gjitha provave të proceduara, gjykata me asnjë provë nuk mundi të vërtetoi faktin se të akuzuarit kishin kryer veprën penale për të cilën janë ngarkuar, për arsye si në vijim:

Në këtë çështje penalo juridike vetëm një rrethanë nuk ka ngel në mëdyshje dhe nuk kontestohet, se në shitoren e të dëmtuarit Zh.S. është hapur me forcë dera e hyrjes së shitores, është depërtuar mbrenda dhe nga aty janë vjedhur lloje të ndryshme të cigareve dhe një telefon “ Samsung E 250”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, me çka të dëmtuarit ju është shkaktuar dëm material në vlerë të pa përcaktuar.

Gjykata në këtë çështje penalo-juridike me asnjë provë të vetme nuk mundi të vërtetoi faktin–tezën e akuzës se të akuzuarit: M.C. e N.B. kishin kryer veprën penale për të cilën janë ngarkuar, në rastin konkret nga dëshmitë e të gjithë dëshmitarve të dëgjuar në shqyrtimin kryesor gjykata nuk mundi të vërtetoi faktin se, të akuzuarit M.C. dhe N.B. kishin kryer vjedhje të rëndë në dëm të të dëmtuarit.

Prokuroria e shtetit ka ngritur akuzën duke u bazuar vetëm në deklaratën e të akuzuarit D.B. të dhënë në stacionin policor në, pa pasur asnjë provë tjetër të vetme për ta mbështet këtë deklaratë (deklaratë e dhënë pa prezencën e avokatit sipas dëshmitarëve deklaratë jo kredibile), bazuar në këtë në kuptim të nenit 123 parag. 5 të KPP-së, prokuroria nuk ka mundur që këtë deklaratë jo kredibile sipas dëshmitarëve ta shfrytëzoj si provë të vetme ndaj të akuzuarve M.C. e N.B., e lëre më ta bazoj edhe aktin akuzues në këtë deklaratë si të vetmen provë në raport me të akuzuarit, gjithashtu në kuptim të nenit 262 parag. 1 i KPP-së, gjykata nuk mund t’i shpallë të akuzuarit fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga të pandehurit ose mbrojtësit përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale, andaj sipas dispozitave të KPPRK-së përgjegjësia penale duhet të vërtetohet në mënyrë bindëse, pra në rastin konkret nuk është vërtetuar e njëjta, pra organi i akuzës ka ngritur aktakuzë pa pasur asnjë provë të vetme për të vërtetuar fajësinë për të akuzuarit, andaj në mungesë të provave të akuzuarit nuk deklarohen fajtor.

Askush nuk mund të shpallet fajtor në bazë të supozimeve pa pasur prova të drejtpërdrejta të cilat do ta përshkruanin me saktësi ekzistimin e fakteve përkitazi me kryerjen e veprës penale, prandaj në të drejtën penale vlen parimi ”Indubio Pro Reo”, pra mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurve dhe të drejtave të tyre në mbështetje të nenit 3 parag. 2 të KPPRK-së.

I dëmtuari Zh.S. nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike.

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur që ato të bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, në kuptim të nenit 454 parag. 1 i KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË KAMENICË

P.nr.24/2013, më datën 31.03.2017

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r j a,

Emine Zubaku,d.v.

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej

15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së

Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.